



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:049553

Datë: 06.10.2020

Numri i dokumentit: 01164960

**PKR.nr.86/2015**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për krime të rënda, divizioni penal, si gjykatë penale e shkallës parë**, në trup gjykues të përbërë prej gjyqtarit Aziz Shaqiri, kryetar i trupit gjykues si dhe të gjyqtarëve : Islam Thaçi dhe Rilind Sermaxhaj – anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.R Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.1. dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s), të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare av.Sadbere Maliqi nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr. 81/2015 të datës 18.06.2015, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Mr.sc.Agron Uka, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datën 25 shtator të vitit 2020, nxjerr kurse kryetari i trupit gjykues në të njëjtën ditë në prani të palëve shpall këtë,

## **A K T G J Y K I M**

**I. I akuzuari** L.R nga i ati S. dhe e ëma Sh. – me mbiemër të vajzërisë N., i lindur më daten... në fsh.Smirë, K.Vitisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij, i tërhiqet vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij, nën kërcënim të pasojave ligjore,

## **Ë s h t ë f a j t o r**

**sepse** më datën 05.04.2015 rreth orës 19.00-19.30h, Komuna Vitisë, me qëllim që t'i sjell vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, në bashkëkryerje kanë kryer vjedhje të rëndë në shtëpinë e të pandehurit J. A, në atë menyrë që me forcë hapin dritaren e ballkonit,

depërtojnë në brendi të shtëpisë dhe nga aty i akuzuari A.A.vjedh për vete një revole të kalibrit 6.35mm me ngjyrë të bardhë, prodhim “C Zastava” dhe një karikator të njëjtës revole, kurse së bashku vjedhin një televizor, karsher për autolarje, mbushës të baterive të veturave si dhe një shpues ( hillt ), e që pas punës operative të Policisë së Kosovës, të njëjtit identifikohen.

-ashtu që me këto veprim në bashkëkryerje ka kryer veprën penale **vjedhje e rëndë neni 327 par.2 nënparagrafi 2.5 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 31 të KPRK-s.**

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të cituara si dhe nenit 4, 7, 21, 41, 45, 46, 47, 73 – 75 paragrafi 1.2 dhe 1.3 të KPRK-s si dhe nenit 365 lidhur me 326 të Kodit të Procedurës Penale ( në tekstin e mëtutjeshëm KPP-s ), të akuzuarin në fjalë,

## **E G J Y K O N**

**me DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë ( 180 ) ditëve, i cili dënim pas shpalljes së aktgjyqimit me pëlqimin shprehimisht të dhënë nga i akuzuari L. R, në kuptim të nenit 47 të KPRK-s,**

**I ZËVENDËSOHET me dënim me gjobë në shumën prej tetëqind ( 800 ) Euro, të cilën shumë i akuzuari duhet që ta paguaj, në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e të pranuar nga i akuzuari në fjalë,**

mirëpo, në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, atëherë dënimi i tillë,

**I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro do të zëvendësohet me një ditë burgim, përkatësisht në kohëzgjatje prej dyzetë ( 40 ) ditëve, të cilin dënim duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga kjo gjykatë, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.**

**III. DETYROHET i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t’ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej njëqind ( 100 ) Euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave shumën prej pesëdhjetë ( 50 ) Euro, të gjitha në afat prej tridhjetë ( 30 ) ditëve, nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.**

**IV. Ndaj të akuzuarit A. A, Komuna e Vitisë është veçuar procedura penale sipas aktakuzës PP.I.nr. 81/2015 dhe ndaj tij ka mbetur në fuqi juridike urdhri për lëshimin e letërrreshtimin kombëtar.**

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan – DKR kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti në bashkëkryerje me të akuzuarin A. A ka kryer veprën penale në dispozitivin II sipas përshkrimit faktik dhe cilësimit juridik si në

aktakuzën lëndore. Sipas nenit 327 par.2 nënpar.2.5 lidhur me par.1 nënpar.1.1 të nenit 31 të KPRK-s parashihet dënimi me burgim prej 3 deri në 10 vjet.

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se me vet faktin që i akuzuari A. A është larguar nga Kosova me qëllim të shmangjes nga përgjegjësia penale lidhur me veprën penale e cila i vihet në ngarkesë si bashkëkryes me të akuzuarin L., e në anën tjetër prokurori i shtetit dhe mbrojtësja e të akuzuarit konsiderojnë se janë përmbushur kushtet ligjore për veçimin e procedurës penale ndaj të akuzuarit A. dhe vazhdimin e seancës së shqyrtimit gjyqësor për të akuzuarin L., trupi gjykues në kuptim të nenit 36 të KPP-s me aktvendim procedural ka veçuar procedurën penale ndaj të akuzuarit A. A, Komuna e Vitisë, i cili gjendet jashtë vendit në adresë të panjohur për gjykatën. Po ashtu ka vendosur që të mbetet në fuqi urdhri për lëshimin e letërrreshtimit kombëtar e posa të plotësohen kushtet ligjore do të lëshohet urdhër për lëshimin e letërrreshtimit ndërkombëtar, duke vazhduar seancën me të akuzuarin L..

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor në kuptim të nenit 323 të KPP-s kryetari i trupit gjykues e ka njoftuar të akuzuarin L. R me të drejtat e tij, ndër të tjera edhe për favorët edhe për pasojat e pranimin të fajësisë, e pastaj i njëjti pas konsultimit me mbrojtësen e tij, me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në ngarkesë. Mbrojtësja e tij por edhe prokurori i shtetit nuk e kanë kundërshtuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me arsyetim se në shkresa të lëndës ka prova të mjaftueshme për mbështetjen e kësaj akuze duke përfshirë edhe kushtet tjera sipas nenit 326 paragrafi 1 dhe 4 të KPP-s.

Kryetari i trupit gjykues pasi që ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 326 paragrafi 1 dhe 4 të KPP-s me aktvendim procedural ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, e pasi që të njëjtin nuk e kanë kundërshtuar palët, ka vazhduar seancën e shqyrtimit gjyqësor me fjalët përfundimtare të palëve.

Gjatë fjalës përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se meqë i akuzuari në këtë fazë të procedurës së shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë, gjykata me rastin e matjes së dënimit duhet t'i merrë parasysh si rrethanat rënduese ashtu edhe ato lehtësuese në mënyrë që dënimi të jetë në suaza të ligjit si dhe të jetë i arsyeshëm. Gjykata duhet të ketë parasysh se vepra lëndore penale është kryer gjatë vitit 2015 pra para gjashtë viteve, pendimin e thellë të të akuzuarit në seancën e sotme gjyqësore për veprimet e pamatura të tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë këtë vepër dhe vepra tjera, kështu që një dënim i arsyeshëm do të ndikonte jo vetëm tek i akuzuari por edhe tek të tjerët në përmirësimin, riintegrimin e tij në shoqëri që mos të përsërisë veprime të tilla penale.

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se e ka pasur të pamundur që ta siguroj pranin e të dëmtuarës në seancë, meqë N. A ashtu siç është shënuar në aktakuzë e në të vërtetë vërtetë cilësin e të dëmtuarit realisht është dashur ta ketë bashkëshortin i saj J. A., mirëpo sipas shkresave të lëndës e njëjta së bashku me bashkëshortin e saj J. A ka dhënë deklaratë lidhur me sendet e vjedhura, e sa i përket kërkesave pasurore juridike të njëjtit gjer në këtë fazë të procedurës nuk e kanë parashtruar.

Mbrojtësja e të akuzuarit gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se me vet faktin që i akuzuari e ka pranuar fajësinë gjatë seancës së sotme gjyqësore vullnetarisht dhe në konsultim me mua si mbrojtëse, i ka propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese gjatë matjes së dënimit e posaçërisht rrethanat e cekura nga prokurori i shtetit siç janë pranimi i fajësisë, kohën e kryerjes së veprës meqë i mbrojturi i saj në atë kohë ka qenë i moshës më të re, gjendjen ekonomike jo të mirë të të njëjtit, se i njëjti ka qenë i papunësuar, se

për hetë të parë është ndeshur me ligjin, se është penduar thellë për veprimin e pamatur të tij dhe ndien keqardhje për këto veprime të pamatura dhe se premtion seriozisht se në të ardhmen do të jetë i kujdesshëm që mos të ndeshet me ligjin, e këtë e deklaroj edhe gjatë seancës së sotme se ndihet i turpruar për këtë veprim të pamatur. E ka njoftuar se i mbrojturi i saj gjendet me punë të përkohshme në Itali dhe është mbajtës i vetëm i familjes pasi që asnjë antarë të saj nuk e ka të punësuar në vendlindjen e tij. Andaj edhe duke i pasur parasysht këto rrethana me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktohet për dënim sa më të butë, me buindje se edhe me te mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit.

Trupit gjykues i ka propozuar që ta tërheq urdhrin për lëshimin e letërrreshtimin kombëtar në kuptim të nenit 537 të KPP-s, meqë i mbrojturi i saj ka shprehur gatishmëri edhe personalisht edhe përmes saj si mbrojtëse të paraqitet në gjykatë ose të njoftohet lidhur me ndonjë ftesë të gjykatës lidhur me këtë çështje penale.

I akuzuari L. R ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij, duke kërkuar falje publike për veprimin e pamatur të tij duke e njoftuar gjykatën se makinën për larjen e automjeteve që e ka pasur në posedim i akuzuari M. R ka shkuar dhe ia ka marrë pasi që paraprakisht atij ia ka shit dhe ia ka kthyer pronarit. Ka premtuar seriozisht se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe se për veprimin e pamatur ndihet i turpëruar.

Trupi gjykues në bazë të provave të bashkëngjitura aktit akuzues e të paadministruara në kuptim të nenit 326 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 por edhe nenin 248 paragrafi 1 të KPP-s me rastin e aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 paragrafi 1 të KPP-s, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari në fjalë ka kryer veprën penale lëndore me përshtkrim faktik tani të ndryshuar nga prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke er shpallur fajtor për këtë veprë penale dhe dënuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të gjykatës për llojin dhe lartësinë e dënimit, janë marrë parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 dhe 75 edhe atë si rrethana lehtësuese ka pasur parasysht : pranimin pa hezitim të fajësisë, pendimin e sinqert për veprimin e ndërmarr penal, premtimin serioz se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të kësaj natyre dhe natyrave tjera, se i akuzuari sipas evidencës zyrtare më parë nuk ka qenë i gjykuar dhe se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, se është mbajtës i vetëm i familjes me punë jashtë vendit, se nga kryerja e veprës penale e gjer në ditën e shqyrtimit gjyqësor ka kaluar periudha kohore më tepër se pesë vite por edhe moshën relativisht të re të të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale, se sendin e vjedhur nga ky i akuzuar ia ka kthyer palës së dëmtuar, rrethana këto të cilat në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 paraesin rethana posaçrishtë lehtësuese. Ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Andaj gjykata duke pasur parasysht gjendjen faktike të vërtetuar me provat e bashkëngjitura aktakuzës lëndore lidhur me akuzën lëndore përkatësisht veprën penale lëndore si dhe rrethanat e lartcekura lehtësuese në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të KPRK-s, është bindur se edhe me një dënim më të butë me burgim nën minimumin e paraparë me nenin 76 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-s, mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-s, pasi që sipas nenit 75 paragrafi 1 të KPRK-s parashihet se gjykata mund të shqiptoj dënim nën kufirin e paraparë me ligj siç është paraparë me nenin 76 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-s, pikërisht duke pasur parasysht rrethanat veçanërisht lehtësuese dhe pranim e fajit nga i akuzuari, e të cilat ndërlidhen me kushtet ligjore sipas paragrafit 1.2 nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të nenit 75 të KPRK-s por edhe me deklaratën e prokurorit të shtetit gjatë fjalës përfundimtare i cili i ka propozuar gjykatës që me rastin e përcaktimit për

llojin dhe larësinë e dënimit t'i ketë parasysh rrethanat e lartcekura lehtësuese të cilat ashtu të sublimuara paraqesin rrethana veçanërisht lehtësuese.

Pas shpalljes së aktgjykimit, i akuzuari L. ka kërkuar fjalën e pasi që i është lejuar gjykatës i ka propozuar se është i pëlqimit që dënimi me burgim t'i zëvendësohet me dënim me gjobë.

Trupi gjykues është tërhequr për të vendosur, kështu që ka ardhur në përfundim se ka kushte ligjore që këtij të akuzuari t'i zëvendësohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve me dënim me gjobë në shumën prej 800 Euro, të cilin duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, gjë që edhe ashtu ka vendosur në kuptim të nenit 47 të KPRK-s duke e shpallur të njëjtin dënim.

Me rastin e shpalljes së dënimit të zëvendësuar, të akuzuarin e ka njoftuar se nëse eventualisht dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj, atëherë në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s, i njëjti i zëvendësohet me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo 20 Euro të gjobës me nga një ditë burgim. Palët në kuptim të nenit 368 të KPP-s janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit në fjalë, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cekura më lart, e të cilat përbëjnë rrethana veçanërisht lehtësuese, në kuptim të nenit 41 të KPRK-s mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit si ndaj të akuzuarit ashtu edhe ndaj qytetarëve potencial që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme.

Dënimi i shqiptuar në rastin konkret shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale lëndore, me synim që tek i akuzuari dhe qytetarët potencial të ngritet morali jo kriminal dhe të forcohet detyrimi shoqëror për të respektuar Kodin Penal dhe dispozitat ligjore që ndërlidhen me këtë Kod, me të cilat mbrohen të mirat e rëndësishme juridike përfshirë edhe pasurinë e qytetarëve si pronë private. Gjykata kur është përcaktuar për dënimin e zbutur me burgim dhe zëvendësimin e tij me gjobë, posaçërisht ka pasur parasysh faktin se pasuria e vjedhur që e ka marrë i akuzuari në fjalë i është kthyer palës së dëmtuar, se nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar afro 6 vite, e gjatë kësaj periudhe i akuzuari nuk është ndeshur me ligjin për kurrëfarë vepra penale dhe ka besuar realisht se ky i akuzuar në masë të madhe është rehabilituar nga veprimet inkriminuese lëndore, duke ju kthyer jetës normale me botëkuptim se vetëm në mënyrë ligjore mund të arrihen efektet pasurore siç edhe është duke vepruar i njëjti, meqë tani punon në Itali, fiton me djersen e tij dhe me ato të ardhura mban familjen. Këtu gjykata ka shtuar ndër të tjera edhe rrethanën reale morale të të akuzuarit pasi që i njëjti duke mbajtur kokën poshtë në foltore në sallën e gjykimit ka kërkuar falje publike për veprimin e pamatur të tij, duke premtuar seriozisht se në të ardhmen nuk do të ndeshet me ligjin meqë për rastin konkret të pamatur ndihet shumë i turpëruar.

Meqë pala e dëmtuar nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike dhe përcaktimin e dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar si kundërvlerë e sendeve të vjedhura gjykata për rrethana objektive nuk ka arritur që vërtetoj, pasi që pala e dëmtuar nuk ka ofruar kurrëfarë prove, lidhur me këtë gjykata nuk ka vendosur e as që e ka udhëzuar të dëmtuarin në kontest civil, meqë një kërkesë e tillë është e karakterit disponibil. Në rastin konkret vlera e sendeve të vjedhura nuk ka qenë element kualifikues i veprës penale lëndore, edhe pse nga provat e bashkëngjitura aktit akuzues i akuzuari në fjalë në shtëpinë e të dëmtuarit ka vjedhur vetëm makinën për pastrimin e automjeteve, e cila edhe i është kthyer palës së dëmtuar.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP.

Po ashtu gjykata në kuptim të nenit 39 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ka vendos për taksën për kompensimin e viktimave të krimit.

Për arsyet e lartcekura, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i krimeve të rënda  
PKR.nr. 86/2015, më dt.05 tetor të vitit 2020**

**Sekretarja juridike,**  
Kadrije Zymberi

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Aziz Shaqiri

**Udhëzim për mjetin juridik:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë ( 15 ) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.